-Gj.A.Pojan
- ST IMP
dt 20.05.2026

BASHKIA MA
Zyra e Protokollit
Nr.3052 Prot
Date 20.5.26 Nenshkri

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE VENDORE KORÇË

Adresa : Lagj.3 Rr "Avni Rustemi" Pranë Ish Prokurorisë së Apelit Kati 2 Korçë Tel/fax.0822456-21

Nr.3308 Prot *Korçë,sot më datë.11.05.2026*

V E N D I M-SHPALLJE

(Lidhur me ekzekutimin e titullit ekzekutiv të debitorit larguar pa adresë jashtë teritorit të Republikës së Shqipërisë)

Drejtuar *: Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë*
Bashkisë Maliq
Njësisë Administrative Pojan

Për debitorin *: Saimir Hasan Shkëmbi banues fshati Pojan Bashkia Maliq Korçë*

KONSTATOVA

Pranë Zyrës Përmbarimore Korçë është depozituar kërkesa e kreditorit Drejtoria Vendore,për Kufirin dhe Migracionin Korçë për ekzekutimin e titullit ekzekutiv proçes verbalin me Nr.0001932 dt.09.10.2025 për të cilin është lëshuar urdhër ekzekutimi me Nr.2856 datë.08.09.2025 të Gjykatës Administrative së Shkallës së Parë Tiranë,me palë dhe me objekt:

-***Kreditor*** *: Drejtoria Vendore,për Kufirin dhe Migracionin Korçë*
-***Debitor*** *: Saimir Shkëmbi*
-***Me Objekt*** *: Gjobë administrative*

Nga ana e kësaj zyre kanë filluar proçedurat në bazë të nenit 515,517,518 e vijues të K.Pr.Civile si dhe ligjit Nr.8 datë.02.02.2023"Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor"

-Nga verifikimi i kryer nga ana jonë në bashkëpunim me organet kompetente rezulton se shtetasi debitor ***Saimir Hasan Shkëmbi dtl.09.06.1974*** të mos ketë marë dijeni për Lajmërimin për Ekzekutim Vullnetar,pasi nuk ndodhet në adresën e banimit,larguar pa adresë konfirmuar nga Bashkia Maliq.

-Lajmerimi me Nr.2055 Prot datë.18.03.2026 i është drejtuar debitorit Saimir Shkëmbi banues fshati Pojan,për përmbushjen vullnetare të detyrimit gjobë administrative,në total shuma prej ***11.200 lekë.***

Sa më sipër në mbështetje të nenit 133/a,133/b të Kodit Proçedurës Civile si dhe ligjit Nr.8 datë.02.02.2023"Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor",si dhe udhëzimit Nr.398 dt.08.02.2011 të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit.

VENDOSA

1-Të kryej njoftimin nëpërmjet shpalljes me afat 20 (njëzet) ditor nga data e marrjes dijeni të Bashkisë Maliq,Njësisë Administrative Pojan si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë,për sa i përket debitorit Saimir Hasan Shkëmbi dtl.09.06.1974 fshati Pojan Bashkia Maliq Korçë.

2-Ky njoftim përpilohet në disa kopje,ku një kopje afishohet në këndin e njoftimeve të kësaj zyre,një kopje dërgohet për afishim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë,Bashkia Maliq si dhe Njësisë Administrative Pojan,sipas ligjit ku ka vendbanimin e fundit debitori.

3-Kjo shpallje ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore Saimir Hasan Shkëmbi dtl.09.06.1974.

PËRMBARUES GJYQËSOR
Haxhiliano TABAKU

KRYETARE
Olta SHKËMBI